



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:206970
Datë: 24.06.2024
Numri i dokumentit: 05852314

Ac.nr.9124/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Hysni Bardheci, kryetar i kolegjit, Bujar Muzaqi dhe Enes Mehmeti, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit B.H., nga fshati O., Komuna Podujevë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson N.R., avokat në Prishtinë, kundër të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme e Kosovës, Policia e Kosovës, me seli në Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson N.K., avokat shtetëror në avokaturën shtetërore të Republikës së Kosovës, me objekt të kontestit, anulim i vendimit, kthimin në vendin e punës, dhe kompensimin e pagave, duke vendosur sipas ankesës së paditësit të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.869/16, të datës 09.06.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 13.06.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. APROVOHET e themeltë ankesa e paditësit B.H., nga fshati O., Komuna Podujevë, **PRISHET** aktgjykimit i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.869/16, i datës 09.06.2021, ashtu që **HEDHET** poshtë padia e paditësit B.H., nga fshati O., Komuna Podujevë, e paraqitur me datë 21.04.2016, kundër të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme e Kosovës, Policia e Kosovës, me të cilën ka kërkuar anulimin e vendimin për largim nga puna nr.021-SHPK-2006, të datës 10.08.2007, kthimin e paditësit në vendin e punës, si dhe kompensimin e pagave dhe kontributit pensional për periudhën nga data 01.09.2007, deri me datë 09.06.2021, **SI E PA LEJUESHME**.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

A r s y e t i m

Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin e atakuar C.nr.869/16, të datës 09.06.2021, ka vendosur si në vijim: “I. REFUZOHET kërkesëpadia e paditësit B.H., nga fshati O. Komuna Podujevë, me të cilën ka kërkuar që të DETYROHET e paditura, Ministria e Punëve të Brendshme – Policia e Kosovës, ta anuloj vendimin për largim

nga puna të paditësit, nr. 021-SHPK-2006, të datës 10.08.2007, dhe paditësin ta kthej në vendin dhe detyrat e punës, ku ka qenë me datë 10.08.2007, Polic në Njësinë e Trafikut Regjionale-Prishtinë, si dhe të ja kompensoj të gjitha pagat nga data 01.09.2007, e deri në ditën 09.06.2021 (data e marrjes së aktgjykimit), duke përfshirë edhe beneficionet të gjitha me kamatë ligjore prej 8 %, në afat prej 7 ditësh, nën kërcenim të përmbarrimit me dhunë, në tërësi SIE PA BAZUAR. II. Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale”.

Kundër këtij aktgjykimi, paditësi përmes përfaqësuesit të autorizuar në afat ligjor ka paraqitur ankesë, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim për Gjykatën e Apelit, që ankesa të aprovohet si e bazuar, të ndryshohet aktgjykimi i atakuar C.nr.869/16, të datës 09.06.2021, dhe të aprovojë kërkesëpadinë e paditësit, apo ta prish aktgjykimin e atakuar dhe çështjen ta kthej në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

E paditura nuk ka paraqitur përgjigje në ankesën e paditësit.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e paditësit është e themeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi, përmes të autorizuarës së tij, me datë 21.04.2016, në gjykatën e shkallës së parë ka paraqitur padi kundër të paditurës, duke kërkuar anulimin e vendimit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, kthimin e paditësit në vendin e punës dhe kompensimin e pagave dhe përfitimeve të tjera gjatë gjithë kohës të largimit të paligjshëm nga puna. Në padi ka parashtruar se paditësi ka qenë i punësuar në Policinë e Kosovës, nga muaj prill i vitit 2000, si zyrtar policor, ku ka punuar në njësi të ndryshme të policisë së fundi në njësinë e trafikut rrugor. Ka theksuar se me datë 23.01.2006, paditësit i është shqiptuar masa e suspendimit me pagesë, pasi që ndaj të njëjtit kishte filluar procedura disiplinore dhe penale, dhe lidhur me këtë rast ndaj paditësit dhe kolegut të tij Prokuroria Publike Komunale, kishte ushtruar propozim akuzë me numër PP.nr.600-14/2006, të datës 24.02.2006, me dyshimin se ka kryer veprën penale “Marrja e ryshfetit”. Ka shtuar se edhe pse gjykata nuk kishte marrë vendim për rastin e filluar e paditura në mënyrë të njëanshme pa mbajtur kurrfarë procedure disiplinore dhe pa e vërtetuar gjendjen faktike me datë 10.08.2007, i ka shqiptuar masën ndërprerje e marrëdhënies së punës, ndaj të cilit vendim paditësi ka paraqitur ankesë me datë 17.08.2007, por i është refuzuar ankesa si e pabazuar. Pas nxjerrjes së provës me ekspertizë financiare, i autorizuari i paditësit ka kërkuar që të detyrohet e paditura që paditësit t’ia bëjë kompensimin e pagave dhe kontributit pensional për periudhën nga data 01.09.2007, deri në vendim përfundimtar të gjykatës datë 09.06.2021, me propozim sikur në fjalën përfundimtare, si dhe t’ia paguaj edhe shpenzimet e procedurës.

E paditura në përgjigje në padi dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor e ka kontestuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit duke konsideruar se e njëjta është e palejuar, me arsyetimin se paditësi e ka paraqitur padinë në gjykatë pas afatit ligjor, gjegjësisht pas 10 viteve pas përfundimit të

procedurës disiplinore e cila ka përfunduar me vendimin e Komisionit të Ankesave të datës 04.12.2007. I ka propozuar gjykatës që padinë e paditësit jashtë seancës ta hedhë poshtë si të palejuar, apo ta refuzon kërkesëpadinë si të pabazuar.

Gjykata e shkallës së parë, duke vepruar sipas padisë së paditësit, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar, C.nr.869/16, të datës 09.06.2021, me të cilin ka refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit duke vendosur me decivisht si në dispozitiv të të njëjtit.

Në arsyetimin e aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë ka konstatuar së në mes palëve, nuk ishte kontestues fakti se paditësi ka qenë në marrëdhënie pune tek e paditura deri në momentin e largimit nga detyra, dhe nuk ka qenë kontestues fakti se e paditura më njoftimin e datës 23.01.2006, e ka njoftuar paditësin se është subjekt i hetimit për supozimin se ka shkelur rregullat dhe rregulloren e shërbimit policor të Kosovës dhe se ndaj tij shqiptohet masa disiplinore “Suspendim me pagese”. Me datë 24.02.2006, ndaj paditësit është ngritur aktakuza nr. PP.nr, 600-14/2006, për shkak të veprës penale “ Marrje Ryshfeti” nga neni 343 par 3, lidhur me par 1 dhe nenin 23 të KPK-së, ndërsa me datë 10.08.2007, njësia e standardeve profesionale, paditësit i ka shqiptuar masën “Ndërprerje e marrëdhënies së punës”. Gjykata Komunale në Podujevë me aktgjykimin P.nr.224/2006, të datës 30.01.2012, ka refuzuar akuzën e prokurorisë dhe e ka shpallë të pafajshëm paditësin. Gjykata e Apelit e Kosovës aktvendimin PAKR.1035/13, datë 03.05.012, lëndën e ka kthyer në rivendosje. Tutje gjykata ka gjetur së paditësi më datë 10.03.2016, me kërkesë ju ka drejtuar të paditurës për rikthim në vendin e punës, ndërsa e paditura me datë 12.04.2016, iu ka përgjigjur në kërkesë paditësit ku ka sqaruar se vendimet e marra në procedurë disiplinore janë përfundimtarë dhe si të tilla nuk mund të rishqyrtohen, ndërsa paditësi nuk ka sjellë ndonjë vendim të gjykatës kompetente për anulimin e vendimeve, pasi që aktgjykimi i Gjykatës Komunale, përkatësisht aktvendimi i Gjykatës Themelore, kanë të bëjnë më procedurën penale të zhvilluar ndaj ish punonjësit dhe nuk prodhojnë efekt juridik përkitazi me kthimin e tyre në punë, respektivisht nuk prodhojnë efekt juridik ndaj vendimeve të nxjerra në procedurë disiplinore.

Me provat e administruara, gjykata e shkallës së parë ka gjetur se me datë 21.01.2006, diku rreth orës 01.12 minuta në piken e kontrollit në relacionin Prishtinë- Podujevë në afërsi të vendit të quajtur “K.” paditësi se bashku me kolegun e tij A.M. i kanë ndaluar tre kamiona për kontrollim, të cilët edhe pse nuk kishin qenë në gjendje të rregullt i kishin liruar pa ju shqiptuar asnjë tiketë. Dhe pasi kanë hyrë në veturë i kanë pa 30 euro, të cilat i ka marrë Arber Makolli. Dhe janë nisur në drejtim të Prishtinës dhe janë thirr në telefon nga Rreshteri G.K., që të takohen të R. por në vend të tij kanë ardh krimet serioze ku edhe janë arrestuar dy policët. Dhe ju janë gjetur partë me numër të njëjtë serik. Po ashtu paditësi gjatë kohës sa ka qenë në suspendim nuk është lajmëruar në kohë të caktuar prej orës 9 e deri në ora 11.00, për 20 ditë të tëra. Këto rrethana gjykata i ka vërtetuar në bazë të deklaratave të dëshmitarëve: “ N.Rr. i cili ka deklaruar se policëve ju janë dhënë 20 euro dhe 10 tjera u ‘a ka dhënë djali i tij L.Rr.” deklarata e Z.N. i cili ka thënë se “ policët një here ju kanë thënë që ti heqin tabelat dhe me pastaj pas 15 minutash është liruar pasi pasagjeri N.Rr. kishte biseduar më policët. Dhe deklaratës se S.T. i cili ka

deklaruar se policëve u'a ka dhënë 10 euro në veturë, këto deklarata gjykata i mori si të besueshme. Gjykata ka gjetur se paditësi nuk i ka përfillur procedurat gjatë suspendimit më pagese duke bërë duke bërë mungesa në listën e lajmërimit ku ka munguar 19 ditë të vitit 2016 dhe 3 ditë në vitin 2007, këtë rrethanë gjykata e vërtetoi më listat e thirrjeve, provë kjo e dorëzuar nga pala e paditur. Gjykata ka gjetur se e paditura ka vepruar konform dispozitave të brendshme, kur paditësit ia ka shqiptuar masën largim nga detyra, pasi që shkeljet e konstatuara nga Bordi i Ankesave i SHPK- së, janë gjetur si të vërteta, duke paraqitur bazë të mjaftueshme për masën të cilën e ka shqiptuar "largim nga puna". Në këtë rast paditësi ka bërë shkelje të Rregullave të Sjelljes dhe të Kryerjes së Detyrës të përshkruara në vendimin mbi largimin nga puna. Përveç dispozitave të brendshme të të paditurës mbi bazën e të cilave gjykata e ka përcaktuar se veprimet e paditësit përbëjnë shkelje të Kodit të Etikës, si dhe shkelje të rënda të rregullave të sjelljes dhe të kryerjes së detyrës, mbi bazën e të cilave e paditura ka nxjerrë vendim të ligjshëm, vendimi për largim nga puna gjen mbështetje edhe në Rregulloren nr. 2001/27, për Ligjin Themelor të Punës në Kosovës, neni 11.1 (c), sipas të cilës depozitë shkëputja e kontratës së punës bëhet edhe në raste e rënda të sjelljes së keqe të punonjësit.

Nga të lartcekurat, gjykata e shkallës së parë ka vendosë sikur në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, ndërsa lidhur me shpenzimet procedurale ka vendosë konform nenit 450 dhe 452.2 të LPK-së.

Gjykata e Apelit duke e ekzaminuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, gjeti se një përfundim i tillë i gjykatës së shkallës së parë është i pa bazuar, për shkak se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.1 lidhur me nenin 391 paragrafi 1, pika f) LPK-së, lidhur me nenin 181 paragrafi 1 të Ligjit mbi Punën e Bashkuar, Gazeta Zyrtare e RSFJ-së, nr.11/1988 datë 10 shkurt 1988, me çka ka ardhur edhe gjerë tek zbatimi apo aplikimi i gabuar i së drejtës materiale kur ka vendosur për bazueshmërinë e kërkesëpadisë edhe pse e njëjta është paraqitur në gjykatë pas afatit të paraparë ligjor.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, gjykata e shkallës së parë gjatë shqyrtimit paraprak të padisë ka për obligim që zyrtarisht të kujdeset për të gjitha prezumimet procedurale, nga të cilat varet lejueshmëria e procesit gjyqësor përfshirë këtu edhe vlerësimin e faktit nëse padia është paraqitur brenda afatit ligjor, në rastet kur me dispozita të posaçme është parashikuar afati për paraqitjen e padisë në gjykatë. Gjykata e Apelit, gjeti se e paditura përmes përgjigjes në padi ka kërkuar nga gjykata e shkallës së parë që ta hedhë padinë e paditësit si të palejuar, me arsyetimin së paditësi e ka ushtruar padinë në gjykatë pas afatit ligjor, gjegjësisht pas 10 viteve pas përfundimit të procedurës disiplinore. Gjykata e shkallës së parë edhe përkundër këtij fakti ka vazhduar me shqyrtimin çështjes duke vendosur në mënyrë meritore për kërkesëpadinë e paditësit, ndërsa në arsyetim të aktgjykimit të atakuar nuk ka dhënë asnjë arsye lidhur me pretendimin e të paditurës nëse padia është paraqitur në gjykatë pas afatit të paraparë ligjor.

Siç është konstatuar edhe në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, e paditura kishte filluar hetimet ndaj paditësit me supozimin se ka shkelur rregullat dhe rregulloren e shërbimit policor të Kosovës, dhe për këtë fakt paditësi ishte njoftuar me njoftimin e datës 21.03.2016, ku i njëjti

ishte njoftuar së si rezultat i fillimit të hetimit është suspenduar me pagesë, duke filluar nga data 23.01.2006, dhe ishte paralajmëruar së nëse vërtetohet shkelja disiplinore masa me ashpër që mund të shqiptohet është largim nga detyra. Nga shkresat e lëndës rezulton së Njësia e Standardëve Profesionale të SHPK-së, pas përfundimit të hetimeve, përkatësisht procedurës disiplinore me vendimin e datës 10.08.2007, i kishte shqiptuar paditësit masa disiplinore “Largim nga Detyra/Puna”. Ndaj këtij vendimi paditësi me datë 17.08.2007, ka paraqitur ankesë drejtuar Kryeinspektorit në Njesisë të Standardëve Profesionale në Shtabin Kryesor në Prishtinë, ndërsa Komisioni i Ankesave-Bordi i Ankesave i të paditurës, me vendimin e datës 26.11.2007, ka vendosur që të refuzon ankesën e paditësit dhe të vërtetoj masën disiplinore Largim nga Puna, i cili vendim konfirmohet edhe në bazë të Vendimit për Rezultatin e Komisionit për Ankesa, Ref.KPS/PD/AP/9723/D, datë 04.12.2007, ku theksohet së ankesa është refuzuar, ndërsa masa disiplinore largim nga puna mbetet efektive.

Në bazë të nenit 178 paragrafi 1 të Ligjit mbi Punën e Bashkuar, Gazeta Zyrtare e RSFJ-së, nr.11/1988 datë 10 shkurt 1988, i cili ligj ka qenë i zbatueshëm në kohën kur paditësit i është ndërprerë marrëdhënia e punës është paraparë së “Kërkesën për mbrojtje të së drejtës punëtori i paraqet organit të caktuar me statut të organizatës, në afat prej 15 dite, nga dita kur ka kuptuar shkeljen e të drejtës, respektivisht nga dita kur i është dorëzuar vendimi me të cilin i është shkelur një e drejtë e tij”. Me neni 179 paragrafi 1 të këtij ligji, përcaktohet se “ Organi kompetent në organizatë është i detyruar që sipas kërkesës së punëtorit të merr vendim në afat prej 30 ditësh nga dita e paraqitjes së kërkesës”. Ndërsa me nenin 181 paragraf 1 të këtij ligji, përcaktohet se: ” Nëse punëtori është i pakënaqur me vendim, apo nëse organi kompetent në organizatë nuk merr vendim në afat prej 15 dite nga dita e paraqitjes së kërkesës, ka të drejtë që në afatin tjetër prej 15 dite të kërkoj mbrojtjen e të drejtës në gjykatë”.

Në rastin konkret është vërtetuar së paditësit i është ndërprerë marrëdhënia e punës nga e paditura me vendimin e datës 10.08.2007, ku i është shqiptuar masa disiplinore Largim nga Detyra/Puna, i cila masë është vërtetuar edhe me vendimin e Bordit të Ankesave të datës 26.11.2007, ndërsa paditësi padinë me të cilën ka kërkuar anulimin e vendimit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës dhe kthimin në vendin e punës e ka parashtruar në gjykatë me datë 21.04.2016, dhe nga kjo rezulton së paditësi e ka ushtruar padinë pas afatit ligjor të paraparë me nenin 181 paragrafi 1 i Ligjit mbi Punën e Bashkuar, ngase nga data kur Komisioni i Ankesave-Bordi i Ankesave i të paditurës ka vendosur që të refuzoj ankesën e paditësit dhe ta vërteton masën disiplinore Largim nga Puna, e cila masë paditësit i është shqiptuar me datë 10.08.2007, e deri me datën e ushtrimit të padisë në gjykatë kanë kaluar me shumë së tetë (8) vite.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, paditësi ka pasur të drejtë ligjore që në mënyrë të lirshme të ushtrojë mjetet juridike brenda afateve ligjore të përcaktuara. Andaj, mos shfrytëzimi i këtyre mjeteve juridike brenda afateve të caktuara (afate prekluzive), ka si pasojë edhe humbjen e të drejtës për mbrojtje gjyqësore, dhe jo për shkak se kjo e drejtë i është mohuar paditësit, por për shkak se ky i fundit ka dështuar që me kohë t’i shfrytëzoj këto mjete juridike të cilat i ka pasur në dispozicion. Kjo pasi që dispozita nga neni 181 paragrafi 1 i Ligjit mbi Punën e Bashkuar, përcakton qartë afatin për paraqitjen e padisë, dhe ky afat është prekluziv, dhe me kalimin e këtij afati humbet e drejta për ushtrimin e padisë. Kjo gjykatë vlerëson së paditësi pas refuzimit të

ankesës nga Komisioni i Ankesave-Bordi i Ankesave i të paditurës, është dashur që padinë për anulimin e vendimit për largim nga detyra/punë, dhe kthimin në vendin e punës ta paraqet në gjykatë brenda afatit prej 15 ditëve siç përcaktohet me 181 paragrafi 1 i Ligjit mbi Punën e Bashkuar, dhe jo të pres përfundimin e procedurës penale që është zhvilluar ndaj tij, dhe pas kalimit të me shumë së tetë (8) vite të paraqet kërkesë për kthim në punë dhe padinë në gjykatë. Kjo ngase procedura disiplinore dhe procedura penale janë të ndara sepse përgjegjësia për shkelje të detyrave të punës mund të konstatohet në procedurë disiplinore pavarësisht faktit së ndaj të punësuarit është ngritura aktakuzë nën dyshimin e bazuar së ka kryer vepër penale gjatë ushtrimit të detyrave të punës, siç ka ndodhur në rastin konkret.

Meqenëse paditësi nuk i është përmbajtur afatit për ushtrimin e padisë në gjykatë për të kërkuar mbrojtje gjyqësore, gjykata e shkallës së parë bazuar në dispozitën e nenit 391 pika f) e LPK-së, me të cilën parashihet së *“Pas shqyrtimit paraprak të padisë gjykata me aktvendim e hedh poshtë padinë si të palejueshme po që se konstaton se: padia është paraqitur pas skadimit të afatit, po që se me dispozita të posaçme është parashikuar afati për paraqitjen e saj”*, është dashur që zyrtarisht pa pasur nevojë për prapësimin e palës së paditur që ta hedhë poshtë padinë e paditësit si të palejueshme. Andaj, meqenëse nga shkresat e lëndës është vërtetuar së paditësi e ka paraqitur padinë në gjykatë pas afatit ligjor, Gjykata e Apelit, bazuar në dispozitat e lartcekura ka vendosur që ta prish aktgjykimin e atakuar dhe ta hedhë poshtë padinë si të palejueshme si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi, pasi që përderisa padia është ushtruar në gjykatë pas afatit të paraparë ligjor, gjykata nuk mund të lëshohet në vlerësimin e fakteve nëse paditësit i është ndërprerë marrëdhënia e punës në mënyrë ligjore.

Për këtë arsye, Gjykata e Apelit, nuk u lëshua në vlerësimin e pretendimeve ankimore së paditësit i është ndërprerë marrëdhënia e punës në mënyrë të kundërligjshme, pasi që me vet faktin së padia është e palejueshme në këtë rast nuk mund të bëhet vlerësimi i procedurës disiplinore dhe i vendimit me të cilin paditësit i është ndërprerë marrëdhënia e punës, sepse procedura në situata të tilla për shkak të pengesave procedurale nuk e lejon.

Vendimin për shpenzimet e procedurës është marrë në bazë të nenit 450 të LPK-së, ashtu që meqenëse është vendosur që padia e paditësit të hedhet si e palejueshme, ndërsa e paditura nuk i ka kërkuar shpenzimet e procedurës, kjo gjykatë vendosi që secila palë t'i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Nga të cekurat më lartë, e në mbështetje të dispozitave nga neni 194 dhe 195 paragrafi 1 pika (b) e LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.9124/2021, datë 13.06.2024

Kryetar i kolegjit-Gjyqtari
Hysni Bardheci